



VENDIM

Nr. 49, Datë 29.04.2016

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENSIMIN E SHOQËRISË
“XHENGO ENERGJI” SH.P.K., NË AKTIVITETIN E TREGËTIMIT
TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2 gërma “d” dhe 110 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “g”; 5, pika 2; 10, pika 3 të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve ERE-s Nr. 108, datë 09.09.2008 dhe nenit 18 pika 1 gërma “a” e Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin nr. 21 datë 18.03.2009 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 29.04.2016, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “XHENGO ENERGJI” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licensuarve për liçensimin në aktivitetin e tregëtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie;

Konstatoi se :

Aplikimi i shoqërisë “XHENGO ENERGJI” sh.p.k, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/ të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3), është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Të dhënat specifike sipas tipit të licensës (neni 9, pika 4./10 gërmat “a”, “b” dhe “c”), janë plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për licensimin e shoqërisë “XHENGO ENERGJI” sh.p.k, në aktivitetin e tregëtimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licensuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s

Petrit AHMETI